




REPublika e Kosovës / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-0/DPK	Nr. Prot.	01-2909/12
Dep.		Br. Prot.	
Nr. l faq.	02	Data	16-08-2012
Broj stranica		Datum	
Nr. pages		Date	
PRISHTINË			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **06.08.2012**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4765/11, për z. *Selim Frangu* – ish Drejtor i Departamentit të Minerave me Flotacion në Kishnicë e Artanë, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4765-11, për Zyrtarin e lartë, z. Selim Frangu – ish Drejtor i Departamentit të Minerave me flotacion në Kishnicë dhe Artanë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Pas identifikimit të rastit (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), sipas të cilit është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, z. Selim Frangu, me një shkrese kthyesë (DPK/DPKI 03-2773/12) ka njoftuar se; që nga janari i vitit 2012, ai nuk ushtron më pozitën e Drejtorit të Dep. që e klasifikonte atë në mesin e zyrtarëve të lartë. Ztr Frangu në këtë shkresë ka njoftuar se nga janari i vitit 2012, ushtron funksionin e shefit të shërbimit teknik në Departamentin e Minierave me flotacion në Kishnicë e Artanë.

Sipas ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pozita aktuale e ztr. Frangu nuk shkakton papajtueshmëri funksionesh, por ztr. Frangu është bërë me dije që në të ardhmen të deklaroj dhe të shmangë çdo situatë që mund të shfaqet si konflikt rast për rast i interesave (Neni 13 i Ligjit Nr.04/L-051).

Kështu, me këto informacione zyrtare, kemi konstatuar se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

Prandaj në bazë të këtyre veprimeve të kryera nxjerrim këtë:

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit



Hasan Prteni / \*